

VENDIM
Nr. 12, datë 19.1.2017

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“M.C INERTE LUMZI” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC “TUÇ”, ME FUQI 4470 kW DHE HEC “LUMZI”, ME FUQI
11000 kW, ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 15470 kW

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 5, germa “a”; 13 dhe 21, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Tuç” dhe “Lumzi”, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Tuç”, me fuqi 4470 kW dhe HEC “Lumzi”, me fuqi 11000 kW, me fuqi totale të instaluar 15470 kW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti